

SHQETËSIME E PËRBALLJE TË SHKOLLËS DHE PRINDËRVE ME ADOLESHENTIN E SOTËM

Aktualisht shkolla në kompleksitetin e vet, mësuesit dhe nxënësit shqiptarë, prindërit, të marrë së bashku, kërkojnë zgjidhjen e disa problemeve si rrjedhojë e përmbysjeve e konceptimeve bashkëkohore në kontekst të ri demokratik.

Shoqëria shqiptare e bashkë me të adoleshentët, pas viteve '90, u ndeshën me dukuri fare të panjohura, ose me ndonjërin prej tyre vetëm të dëguara.

Në shoqërinë shqiptare, si në vendet post komuniste, vërehen shumë dallime e ndryshime në qëndrimet ndaj vlerave dhe kaheve formuese të shkollës. Pikërisht, prej kësaj fryme e qëndrimi tjetër ndaj shkollës e shkollimit, janë ndikuar dhe janë prekur edhe qëndrimet e nxënësve nga njëra anë dhe, në anën tjetër ato të mësuesve dhe të prindërve.

Me të drejtë nënvizohet se duke ditur që marrëdhëniet mësues-nxënës, në thelb janë dukuri brenda njerëzores, duhen vlerësuar si një lidhje e ndërsjellë bashkëveprimi midis dy a më shumë vetave që punojnë bashkërisht në fusha të caktuara pune dhe jete. Pjesa më e madhe e njerëzve tanë duan disiplinë, vlera të qarta që ndikojnë në zhvillimin e karakterit, vlera këto që formohen, mësohen e praktikohen në shkollë dhe familje.

Kushtet e reja bënë që shoqëria të përballej me këto zhvillime, të bënte kujdes, nëse duhet bërë diçka, por pa treguar se ç'duhet bërë. Mirëpo edhe kjo krijoi një vakum që vazhdonte. Në këtë periudhë tranzicioni, shumë ëndrra e vizione u këputën, u vyshkën. Pa dashur t'i zmadhohj gjërat, duhet thënë se adoleshentët, sidomos ata të shkollës së mesme, u ndjenë shpresëhumbur, pasi ende nuk po shohin perspektivën për hapje vendesh pune ose për të ardhmen e tyre.

Problemi i marrëdhënieve të subjekteve kryesore vepruese në shkollë është e mbetet i tillë që, ndonëse me emërtime të veçanta ka tërhequr e merituar vëmendjen e shumë specialistëve të fushave të tilla, si të pedagogëve e psikologëve, sociologëve e edukatorëve, prindërve, juristëve etj. Gjithashtu po këta specialistë nuk i ndajnë këto subjekte

veçmas (mënjandë shkolla, më tej prindërit dhe më tutje adoleshentët, në të kundërtën edhe rezultatet nuk do të jenë ato që pritëshin). Këto tri “kështjella”, secila në vete, s’do të kishin vlerën e duhur.

Shoqëria e sotme nuk mund të ndërtohet e të përparojë, nëse anashkalojmë subjektin kryesor, nxënësin, shkollarin, i cili është e nevojshme të kuptojë rolin e tij në këto marrëdhënie. Është e domosdoshme të dihet se shndërrimet e thella demokratike në fushat e ndryshme të veprimtarisë njerëzore, si ato politike, ekonomike, sociale, arsimore, kulturore etj., kanë futur në vorbullën e saj edhe shkollat. Kjo është arsyeja që autorët i kanë parë këto probleme, aq të lidhura bashkë në tri plane, si një problem i madh pedagogjik, si një problem psikologjik dhe së treti si një problem social. Këto tri probleme kanë një gërshetim të pandashëm nga njëri-tjetri dhe s’mund të flasësh për njërin pa përmendur edhe tjetrin.

Në shoqërinë shqiptare sot ka shumë ndryshime në qëndrimet ndaj vlerave dhe kaheve formuese të shkollës. Pikërisht prej kësaj fryme e qëndrimi tjetër ndaj shkollës e shkollimit, janë prekur e preken në mënyrë të ndjeshme edhe qëndrimet e sjelljet e nxënësve si ndaj mësuesve ashtu edhe ndaj shkollës, por edhe ndaj njëri-tjetrit.

Ka pasur e ka diskutime se cili institucion e ka për detyrë e funksion punën edukative, parandaluese e udhëzuese me shkollat.

Së pari, është e nevojshme të kuptohet që fillimisht jo gjithçka mund ta bëjë shkolla. Ajo synon që të realizojë qëllimet e saj mësimore dhe edukative. Ndonëse kjo e fundit vetëm sa planifikohet, se nuk plotësohet as 40%, lipset të theksohet se edhe nxënësit-adoleshentë kanë botën e tyre dhe të drejtat e tyre. Në kushtet e demokracisë shumë marrëdhënie në shkollë kanë pësuar ndryshime. Dukuritë e reja që ndeshen sot në shkolla hasen çdo ditë, por ose nuk njihen siç duhet, ose nuk vlerësohen. Këto zhvillime, perspektiva e tyre, orientimet e tyre drejt së resë është e dobishme të njihen, sepse vetëm në këtë mënyrë mund t’i ndihmojmë të rinjtë e të rejtat, nxënësit e mësuesit e midis të tjerëve edhe komunitetet e prindërve. Shndërrimet e thella politike, ekonomike, sociale, arsimore, kulturore etj., janë reflektuar në jetën dhe veprimtarinë e shkollës, por në shkolla ka ende rrëmujë, ka konfuzion dhe lindin konflikte.

Në ditët tona bëhen përpjekje të prindërve për t’i dërguar fëmijët në kurse të ndryshme duke synuar që ata të gjejnë veten, të shquhen, të përparojnë. Kjo është e dobishme. Veçse nga të gjithë duhet kuptuar se arsimi është një ndërmarrje e përbashkët, në të cilin nuk duhet të ketë të fituar dhe të humbur. Qëllimi i shkollës është që me përpjekje të përbashkëta të gjithë të fitojnë, si nxënësit e bashkë me ta edhe mësuesit.

Drejt kësaj duhet synuar dhe, në qoftë se nxënësit dhe mësuesit besojnë në këtë gjë dhe i shfrytëzojnë të gjitha rezervat për realizimin e saj, atëherë është e sigurt se kjo është e ardhmja e këtyre marrëdhënieve.

Së dyti, roli i familjes mbi të riun apo të renë, nuk është i shkëputur nga veprimi edukativ i shkollës, pasi subjekti që ata i drejtohen është i njëjtë. Kjo ka bërë të mundur që ngjashmëria e pikëpamjeve edukative shkollë-familje, e lejojnë këtë të fundit të luajë rolin e saj mbështetës dhe plotësues të veprimtarisë edukative shkollore, të ndihmojë për kryerjen e detyrave të shtëpisë, të bashkëpunojë për kërkimin dhe sigurimin e dokumenteve që i duhen etj. Edhe në situatën më të favorshme, mësuesi nuk mund të bëjë gjithçka në klasë. Familja mund të ndihmojë në plotësimin e veprimtarisë së tij në drejtim të dokumentacionit, vizitave në ekspozita ose muze, spektakle etj. Është detyrë e mësuesit për të bërë gjithçka, për të siguruar koherencën e duhur nëpërmjet kushteve të jetesës së fëmijëve dhe përmbajtjes shkollore, sepse duhet t'i largohemi atij çasti, që shkollari nuk u beson atyre gjërave që ka mësuar në shkollë. Kjo është disfatë dhe disfata në arsim e çon zhvillimin e vendit disa dekada pas.

Gjatë gjithë jetës, jemi mësuar t'u mësojmë të drejtave, duke harruar atë tjetrën, se të drejtat tona fillojnë kur nuk cenohet liria e tjetrit. Kjo është thënë e stërthënë, por rezultatet janë gati zhgënjyese. P.sh. marrim një klasë të tejmbushur me nxënës, me rreth 45 vetë. Liria e shprehjes së fjalës dhe e mendimeve është një liri e madhe dhe e pamohuar. Madje thuhet është edhe universale. Po ç'mund të bëhet në një klasë, sikur 45 adoleshentë të flasin, fjala vjen tre nga tre e pse jo edhe radhazi. A do të zhvillohej mësim?! Qetësia këtu është shumë e dyshimtë. Ka nxënës adoleshentë, që në orën e mësimt, shkëmbejnë pusulla me njëri-tjetrin, shkëmbejnë revista ku ka shumë nënvizime "domethënëse" për atë që e lexon, ose aty brenda ka vjersha dashurie që përshkruajnë bukurinë fizike të partneres ose të partnerit. A është kjo klima e përshtatshme në të cilën duhet t'i ushtrojnë ndikimet e tyre edukative, shkolla dhe familja? Megjithatë këto funksione mbeten dhe, si të tilla, lipset të synohet të bashkërendohen veprimtaritë: shkolla vë një tullë, familja i vë llaç. Paçka se kjo tullë dhe ky llaç duhen përforcuar dita-ditës.

Për të depërtuar në botën e këtyre adoleshentëve është e vështirë. A mjafton vetëm shpjegimi dhe sqarimi i problemeve?! Praktika negative e këtyre viteve tregoi se u shfaqën shumë mangësi e të meta. Lidhur me këtë, profesori i universitetit amerikan të Harvardit, bihevoristi Skinner, ka nënvizuar: *"Nuk është e mjaftueshme t'i japësh nxënësit vetëm këshilla. Duhet t'i shpjegosh atij se për të pasur një të ardhme, ku të plotësojë dëshirat e tij, për*

të pasur sukses në jetë, ai duhet që tani të përvetësojë disa shkathtësi dhe dije. Këshilla e thjeshtë është e paefektshme, sepse nuk ka rezultate të menjëhershme. Nxënësi kërkon arsyet dhe shkaqet, qofshin pozitive apo negative, por vetëm përcaktuesit e politikës arsimore duhet të marrin të ardhmen në konsideratë (duke përcaktuar objektivat afatshkurtra dhe afatmesme-AK). Duket sikur shumë lëndë janë të shpikura, por s'ka asgjë të keqe në to. Është detyrë e mësuesit të krijojë kushte, sipas të cilave studentët duhet të mësojnë. Lidhja e tyre me dobinë e së ardhmes, nuk është e thënë të jetë e dukshme, e qartë”¹

Pavarësisht se nxënësit duan të kenë marrëdhënie normale me mësuesit, ka faktorë të tjerë që ndikojnë në prishjen e rregullit, ka sjellje të pahijshme, pihet duhan, alkool, tentohet për drogë, influencon filmi, njohja me një mik(e). Të gjitha këto kërkojnë që roli i shkollës, i mësuesve, i familjes të jetë i ndjeshëm. Shfaqje të tilla e të tjera të reja hasen gati çdo ditë në shkollë, në mjediset përreth, jashtë saj etj. por nuk merren në konsideratë. Korrentet e reja, perspektiva e tyre, është e dobishme që këto dukuri të njihen, sepse në këtë mënyrë mund të ndihmohen të rinjtë shkollarë, mësuesit, drejtoritë e shkollave dhe, në një plan me ta, rrjedhimisht, edhe komunitetet e prindërve.

Së treti, një nga funksionet e edukimit është ta përgatisë njeriun për t’u përshtatur kësaj bote, për të cilën bagazhi biopsikologjik i tij është i gatshëm t’u përgjigjet nxitjeve të jashtme. Pra, edukimi ka funksion themelor ndihmës, të zhvillojë dhe të krijojë funksione të reja që i lejojnë individit t’u përgjigjet interesave të veta dhe kërkesave të botës që e rrethon. Tërësia e sistemit edukativ përbën një nga forcat që përcakton përparimin e shoqërisë. Sigurisht sistemi edukativ i shkollës nuk është i vetëm, kështu që me gjithë përpjekjet, ajo nuk mund të përcaktohet si përfaqësuesi numër një i zhvillimit shoqëror. Kjo është arsyeja, theksojnë studiuesit, se është e gabuar të akuzosh shkollën si shkaku i kriminalitetit, papunësisë, i degradimit të vlerave, pasi vetë sistemi shkollor është derivati i shoqërisë në të cilën ekziston, ndaj rrjedhimisht edhe përgjegjësitë në këtë fushë shpërndahen.

Së katërti, adoleshentët dhe prindërit është mirë të përballen me përvojën e huaj. (Një parantezë e vogël: Është folur e do të flitet ende për përvojën e huaj, sepse ajo është në majë të shndërrimeve e zhvillimeve aktuale në vendet e tyre. Kjo përvojë në shumë fusha ka mbetur si parullë, por pak, ose aspak është bërë e po bëhet për ta adaptuar mirë, thellësisht. Kjo ka tri arsye: niveli i njerëzve që e kanë “vjele” këtë përvojë, është i ulët profesionalisht; ka

1 Skinner, *The Free and Happy student*, New York, University Education Quaterly IV, no. 5 Janary 1978/2-6.

hallakatje në vjeljen e saj, kur sisteme të ndryshme shkollimi lundrojnë në eterin e arsimit të padrejtuar; dhe këto përvoja mbushin librat e studiuesve, të zberthyerat e të gatshme për t'i marrë, – kjo është gjëja më e dobishme – , por asnjë ose s'i kupton ose nuk do t'i marrë, se u bë filan-fisteku të na japë mend. Po unë, ku jam që kam gjithë këtë post?).

Është domosdoshmëri që shkollës dhe mësuesit t'i shërbejnë praktika e qasja nga Europa, sepse përvoja e arsimit atje duhet të shërbejë që arsimimi i brezit të ri të mbështetet mbi baza shkencore bashkëkohore.

Sipas Ministrisë së Arsimit të Francës, mbështetur në studime, në ciklin fillor nxënësit duhet të lexojnë 450-500 faqe (bashkë me figurat), në klasat V-VII duhet të lexojnë 1600-1800 faqe, kurse në fund të klasës VIII (tek në klasa IX) çdo nxënës duhet të ketë studiuar 15 vepra të autorëve vendas ose të huaj të përkthyer mirë, 10 nga të cilat janë marrë nga lista e autorëve të përfshira në program. Mësuesit organizojnë ndarjen e veprave sipas nivelit duke respektuar ekuilibrin midis epokave dhe gjinive.²

Në shqetësimin për shkollën, p.sh. në Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë përfshirë të gjithë. Në të janë përfshirë politikanë e prindër, studiues të arsimit e mësues, adoleshentët, firma e fondacione etj. Në shkollat e huaja ky shqetësim është i lidhur direkt si me rezultatet në mësim, ashtu edhe me edukimin e nxënësve. Suksesin në mësim ata e shikojnë si rrjedhojë e punës intelektuale të vetë nxënësve, por pazgjidhshmërisht edhe të punës së mirë të shkollave të mira, të drejtorisë, të prindërve, të mësuesve dhe të gjithë stafit që kanë mundësuar atmosferën normale të marrëdhënieve bashkëpunuese nxënës-mësues, nxënës-nxënës dhe nxënës-prindër. Duhet kuptuar drejt se këto marrëdhënie janë të varura nga veprimtaria dhe organizimi i punës së drejtorisë dhe stafit të mësuesve në shkollë, ashtu edhe i prindërve në tërësi, në shtëpi e jashtë saj. Nisur nga këto, studiuesit kanë gjetur një model të përbashkët karakteristikash, të cilat përmbliidhen në teorinë e mëposhtme 5 – faktorëshe të shkollave efektive, që janë:

1. Udhëheqje e fortë administrative.
2. Pikësynime të qarta shkollore të ndërthurura nga aftësi mendore dhe administrimi.
3. Një ambient i ngrohtë dhe i sigurt shkollor.
4. Kontrolli dhe vlerësimi i shpeshtë i përparimit të nxënësve.
5. Kërkesa të larta ndaj përparimit të tyre.

Së pesti, në ditët tona, ndërtimi i marrëdhënieve normale me të rinjtë e shkollës së mesme, si nga mësuesit dhe nga prindërit, është një proces i

2 Ministero de l'Education Nacional, *Collegs, programmes et institutione*, 1985.

vështirë që kërkon më shumë dije dhe mjeshtri pedagogjike.

T'i mësosh fëmijës si duhet të mësojë pasi vjen nga shkolla dhe t'i mundësosh çdo fëmije zhvillimin e intelektit të tij, është gjithashtu e rëndësishme. Dihet se asnjë lëndë mësimore nuk mund të përvetësohet pa ditur ta interpretosh tekstin, pa u futur në brendinë e tij, pa e paraqitur atë sa më bukur.

Po kështu duhet vepruar edhe pas leximit të një libri. Pas leximit të tij është e dobishme që fëmija t'u përgjigjet katër pyetjeve, të cilat mund ta ndihmojnë prindin ose mësuesin për të kuptuar se sa nxënësit i kanë kuptuar e përvetësuar njohuritë që përmban libri. Pyetjet duhet të jenë interesante, sepse vetëm kështu do t'i nxisnim të gjithë në diskutimin e çdo teksti.

1. Cili është për ju informacioni më i rëndësishëm (ose ajo që e vlerësoni si më të rëndësishëm) në këtë libër?
2. Ç'gjë e re ju bëri përshtypje në të? (Ç'gjë të re mësuat, nga ato që nuk i dini?)
3. Çfarë gjërash të tjera do të donit të dinit dhe nuk i gjetët në libër? (Mësuesi përgatitet që ta shënojë informacionin që i mungon)
4. Të lexojë forma të ndryshme shprehjesh si ngjarje, lajme gazetash, poema, letra etj.³

Të gjithë lexuesit e suksesshëm përdorin mënyra të ndryshme të të lexuarit, pa menduar se po përdorin një teknikë të caktuar, që në disa raste quhet edhe strategji.

*“Ndryshimet e shumta konceptuale të ndodhura në optikën e mjedisit social shqiptar, siç mund të jenë ato në legjislacionin e sotëm shkollor, zhvillimet e reja social-ekonomike të familjes, integrimi i vlerave të kulturave të shumta europiane e botërore që ushtrojnë ndikimin e tyre në familjet shqiptare, emigracioni si një dukuri e re në këtë periudhë kohe, lëvizja e lirë e familjes nëpër zonat gjeografike të vendit etj., krijojnë gjithashtu situata të reja në marrëdhëniet prind-adoleshentë dhe në mospërputhjen e tyre për problemet e sotme të shkollës”.*⁴

Kjo jetë tepër e vrullshme, këto shndërrime të mëdha urbanistike, ndryshimet e dukshme në mikro e në makromjedisin, këto dukuri të reja në psikologjinë e njerëzve nuk ka si të mos reflektonin në familje edhe te të rinjtë. Këto zhvillime krejt të panjohura për ne, që fillojnë nga njohja me botën, kanë treguar edhe anën e pasme të medaljes. Në qytet e mëdha është spostuar deri në një farë mase roli i familjes, duke fituar një terren

3 Arian Kadiu, *Hape portën e artë të leximit*, Tiranë, 2004, f. 28.

4 Arian Kadiu, *Adoleshentët dhe tranzicioni*, Tiranë, 1997.

më të madh mjedisi. Diku më shumë e diku më pak të krisurat janë të dukshme. Kjo nuk do të thotë aspak që roli i familjes nuk është i madh.

Me qëllim që të mos ndodhë divorci shkollë-familje që kohët e fundit po bëhet i pranishëm (prindërit kërkojnë llogari vetëm për notat), ku i humbur është i riu apo e reja, është e domosdoshme që të dy palët të dallojnë e të veçojnë edhe anët pozitive të subjektit që u drejtohen. Në biseda dhe intervista të rinjtë shprehen: *“Ne nuk kemi vetëm të këqija. Kur na thonë se jemi të zotët për këtë ose atë, marrim krabë dhe sjellja jonë është e pëlqyeshme”*. Për këtë, duhet që: *“Zotësia e prindit është të dallojë e të kërkojë anët më të mira të fëmijës dhe jo ato që duhen qortuar. Këto të fundit bien menjëherë në sy. Shprehjet: “Ti je fëmijë i keq”, “Ti je dembel”, “Ti je idiot”, “Na e ke prurë në majë të hundës”, “Asgjë nuk di të bësh si duhet”, “Si nuk të vjen turp nga shokët”, e të tjera si këto (aq më shumë godasin kur thuhet në prani të shokëve ose njerëzve të tjerë), ndikojnë negativisht mbi fëmijën, e fyejnë atë, prekin dinjitetin e tij”*.⁵

Dihet se në familje jo gjithçka shkon vaj, madje kundërshtitë herë janë të dukshme, herë fshihen, herë janë të ashpra (me klithma e me britma), herë të qeta, por kundërshti ka. Pra, kuptohet se sjellja e pahijshme, konfuzioni që shfaq i riu në shkollë vjen shpesh me shkak nga familja, nga grindjet, debatet që hera-herës janë fyese etj. Kështu ndonjëherë, pa u menduar gjatë, njëri nga prindërit ose të dy bashkë, motra më e madhe, vëllai, si të thuash, ndezin urët e irritimit tek adoleshenti. *“Në jetën e përditshme, shkak kryesor i sjelljes pa takt nga ana e të rriturve në familje është gjendja jo e mirë shpirtërore e nënës, apo e babait që është pasojë e ndonjë ndjenje të papëlqyeshme që ka në punë, ose jashtë saj, gjendja jo e mirë shëndetësore, ose rënie e humorit nga lodhja. Në raste të tilla prindërit janë gati të shfryjnë mbi fëmijën”*.⁶

Ndonëse *“...në moshën parashkollore dhe të ulët shkollore, ai pranonte ta qortonin e ta ofendonin, ta kontrollonin në çdo hap që bënte, në moshën e mesme shkollore ai nuk e pranon këtë trajtim. Jo vetëm kaq. Ai nis dhe u kthen fjalën prindërve, nuk janë të rralla edhe rastet kur proteston. Përmbajtja e protestës së tij shprehet me fjalët: “Nuk pranoj të më trajtojnë si të vogël, të më mbikëqyrin dhe të më drejtojnë si fëmijë”*.

Në ditët tona, ndërtimi i marrëdhënieve normale me të rinjtë, veçmas në klasat e ndërmjetme të shkollës së mesme, si nga mësuesit dhe nga prindërit është një proces i vështirë që kërkon më shumë dije dhe mjeshtri pedagogjike. *“Ndryshimet e shumta konceptuale të ndodhura në optikën e mjedisit social shqiptar, siç mund të jenë ato në legjislacionin e sotëm shkollor,*

5 UNICEF, *Shqipëria, gratë dhe femrat në fund të mileniumit*, Tiranë, 2000.

6 Myra e Savid Sadker, *Shkollat, mësuesit dhe shoqëria*, Tiranë, 1995.

zhvillimet e reja social-ekonomike të familjes, integrimi i vlerave të kulturave të shumta europiane e botërore që ushtrojnë ndikimin e tyre në familjet shqiptare, emigracioni si një dukuri e re në këtë periudhë kohe, lëvizja e lirë e familjes nëpër zonat gjeografike të vendit etj., krijojnë gjithashtu situata të reja në marrëdhëniet prind-adoleshentë dhe në mospërputhjen e tyre për problemet e sotme të shoqërisë e të shkollës”.⁷

Shkolla shqiptare po përjeton nevojën për të ndryshuar diçka në ndërgjegjësimin e nxënësve për të drejtat e individit në shoqëri. Në këtë kuadër, edhe diskutimet rreth filozofive arsimore, integrimi lëndor, teknologjia e sotme arsimore etj, s’janë gjë tjetër veçse përpjekje për t’u dhënë zgjidhje perspektivave të shkollës si institucion social. Përpjekjet për t’i dhënë hapësirë hapjes e afrimit me shkollat perëndimore, nuk janë më në fillimet e veta. Megjithëse aktualisht është pozicionuar rreth pikëmbërritjes së shkollës në të ardhmen, por ende nuk janë përcaktuar rrugët dhe mjetet që të çojnë atje.

Në kërkim të këtyre rrugëve, shkolla jonë ka veçuar si të rëndësishme, misionin social e formimin qytetar të nxënësve. Ndaj veçimi dhe vlerësimi i edukimit të të drejtave të njeriut në shkollë, nuk shihet si rastësi.

Shoqëria e sotme shqiptare ka shpallur përkushtimin serioz për të qenë një shoqëri demokratike dhe humane, që përmban si përkushtimin, ashtu edhe përgjegjësinë për secilin individ, organizëm apo institucion që bën pjesë në të. Në këto kushte, ai që përforcon detyrimin dhe rrit përgjegjësinë është vetë realiteti shqiptar me ndjeshmërinë e nevojshme në këtë rrafsh. Formimin e një personaliteti të ri, synon ta plotësojë njëherësh, edhe shkolla dhe edukimi.

Nëse shkolla dhe prindërit i fusin të rinjtë shkollarë tanë në rrugën e njerëzve që lexojnë, atëherë duhet kuptuar se kjo është një betejë tepër e rëndësishme, e cila është edhe e dobishme. Për çdo dekadë kohe që kalon, aq më e nevojshme ndihet forca e dijes dhe e shfrytëzimit të librit në ndihmë të përparimit dhe të dijes së çdo individi. Leximi më pas bëhet rroba e duhur e formimit të të rinjve me tiparet e një njeriu modern, jo larg bashkëmoshatarëve të tij. Kjo është një betejë e madhe dhe e fituar, sepse dihet që nxënësit që lexojnë janë më të diturit e më të suksesshmit.

Në shoqërinë shqiptare sot ka shumë ndryshime në qëndrimet ndaj vlerave dhe kaheve formuese të shkollës. Pikërisht prej kësaj fryme e qëndrimi tjetër ndaj shkollës e shkollimit, janë prekur e preken në mënyrë të ndjeshme edhe qëndrimet e sjelljet e nxënësve si ndaj mësuesve ashtu

edhe ndaj shkollës, por edhe ndaj njëri-tjetrit.

Pavarësisht se sot, me zhvillimin e demokracisë, shkolla jonë është çliruar nga shumë parime e mendësi të tilla, që donin të përgatisnin robotë, dhe është arritur që edhe në përmbajtjen e saj janë përçarur koncepte e praktika demokratike, përsëri ajo vazhdon të vuajë dhe të reflektojë ndikime dhe komplekse, që bien ndesh me parimet e pedagogjisë moderne dhe edukimit të lirisë. Krahas tyre, një rol parësor ka edhe ndërtimi i kurrikulës së re. Për këtë mbahen gjithmonë parasysh nenet e Konventës së të Drejtave të Fëmijëve të vitit 1989.

Përfundime

Shoqëria e sotme shqiptare ka shpallur përkushtimin serioz për të qenë një shoqëri demokratike dhe humane, që përmban si përkushtimin, ashtu edhe përgjegjësinë për secilin individ, organizëm apo institucion që bën pjesë në të. Në këto kushte, ai që përforcon detyrimin dhe rrit përgjegjësinë, është vetë realiteti shqiptar me ndjeshmërinë e nevojshme në këtë rrafsh.

Në shoqërinë shqiptare, si në vendet post komuniste, vërehen shumë dallime e ndryshime në qëndrimet ndaj vlerave dhe kaheve formuese të shkollës. Pikërisht, prej kësaj fryme e qëndrimi tjetër ndaj shkollës e shkollimit, janë ndikuar dhe janë prekur edhe qëndrimet e nxënësve nga njëra anë dhe, në anën tjetër ato të mësuesve dhe të prindërve.

Në kërkim të këtyre rrugëve, shkolla jonë ka veçuar si të rëndësishme, misionin social e formimin qytetar të nxënësve. Ndaj veçimi dhe vlerësimi i edukimit të të drejtave të njeriut në shkollë, nuk shihet si rastësi.

Bibliografia

1. Skinner, *"The Free and Happy student"*, New York, University Education Quaterly IV, no. 5, Janary 1978/2-6).
2. Ministerio de l'Education Nacional, *"Collegs, programmes et institutione"*, 1985.
3. Arian Kadiu, *"Hape portën e artë të leximit"*, Tiranë, 2004, f. 28.
4. Arian Kadiu, *"Adoleshentët dhe tranzicioni"*, studim, Tiranë, 1997.
5. UNICEF, *"Shqipëria, gratë dhe femrat në fund të mileniumit"*, Tiranë, 2000.
6. Myra e Savid Sadker, *"Shkollat, mësuesit dhe shoqëria"*, Tiranë, 1995.